

URDHËR
Nr. 233, datë 3.8.2022

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM KOMPETENCASH

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 21, shkronja “a”, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 30, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, për shkak të lejes vjetore të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së përfaqësimit të institucionit në marrëdhëniet me palët e treta, znj. Laerta Rooze, Sekretare e Përgjithshme e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.
 2. Delegimin e kompetencës së mësipërme për periudhën 8.8.2022–15.8.2022.
 3. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, znj. Laerta Rooze.
 4. Znj. Laerta Rooze nuk mund ta nëndelegojë këtë kompetencë.
 5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Albana Shtylla